

HUNGARY ALBANIA BOSNIA AND HERZEGOVINA CROATIA MONTENEGRO SERBIA SLOVENIA

FOREER



April 2014 | XVIII Issue 04

PËRTËRIJU

ëndërrat!



Rex Maughan

Pavarësisht se në cilin hemisfer jeton, pranvera është koha kur shkundim mantelin e dimrit, lajmë xhamat e dritareve, mbjellim fidanat e reja në kopësht, dhe fillojmë të zbatojmë të gjitha ato plane që kemi menduar në dimër. Ndërkohë çelin lulet dhe kaktuset e natyrës, koha këtu në Arizona fillon e ngrohet dhe nis stina më e dashur e vitit, me mbasdreke të ngrohta dhe mbrëmje të freskët. Pranvera është një nga gjerat më të bukura që më pëlqen në Arizona. Kjo është stina më perfekte për eskursione dhe për atë që të njihemi me vende të tjera dhe të zëmë miqësi të reja. Në Forever pranvera nënkupton mbarimin e periudhës të kualifikimit të Eagle Menaxherëve. Disa nga ju i ka kapur ndjenja e gëzuar e emocioneve, që arritën ta realizojnë; ka nga ata që as nuk e provuan ta arrinin, por pati edhe nga ata që për pak nuk u kualifikuan. Ne të gjithëve u themi „përgëzime”.


Mund të dëgjoh ndonjë nga ju të më pyes, po si i „përgëzon” edhe ata që nuk e provuan? Rex, çdo të thotë kjo?

Çelësi i çdo gjëje në jetë është që të mësosh diçka nga gabimet. Shpresoj që çdo njeri të ketë mësuar nga përvoja e tij me stimulim e Eagle Menaxherit të vitit 2013. Por shpresoj që edhe ata që nuk e provuan, ta provojnë atë në 2014. Ata që nuk e arritën kualifikimin për pak pikë, nga vetë përpjekjet e tyre më të mëdha dhe më të fuqishme, nuk do të mbeten pa e realizuar atë në 2014. Edhe ata që e realizuan dhe po bëhen gati për në Lake Tahoe, me siguri do ta arrijnë atë edhe në 2014. Ashtu si natyra rilind në pranverë, të gjithë ne do të vazhdojmë që në çdo minutë të çdo dite, të luftojmë për tu rritur dhe për tu bërë më të mirë.

Në Global Rally-n e Londrës, para 20 mijë distributorëve dhe miqve ne do të shpallim vendin e takimit të Eagle Manager Retreat për vitin 2015. Ju premtoj se do tju pëlqejë shumë. Pra filloni pikërisht tani të ndërtoni biznesin Eagle!

Në qoftë se do të mund tju jepja një ide, se si të ndërtoni një biznes të sukseshëm, fitimprurës dhe afatgjatë, atëherë kjo do të ishte këshilla: Mëso si Eagle, Praktikohu si Eagle dhe Bëhu edhe ti Eagle menaxher. Në qoftë se ju njihni dhe përqafoni stimulim e Eagle menaxherit, ju dhe biznesi i ngritur prej jush do të ngjitet lartë, duke ju sjellur lumturinë dhe atë që keni dëshiruar.

I juaji përjetë!



VRULL PRANVEROR

Lulëzojnë pemët, dhe shkurret, kopshtet shpërndajnë aromën e këndëshme pranverore, natyra zhurmon, merr jetë dhe u ripërtëri. Hedhim rrobat e ngrohta të dimrit, dhe ikim drejt parkut më të afërt, apo në koshtin e të mbjellave ose të frutave, sepse pak lëvizje ju bën mirë të gjithëve. Bota bëhet më e përsheptuar, se fillojnë të lëvizin hormonet.

A e ndjen ti këtë vrull me të vërtetë, je akoma në gjendje të rigjenerohesh? A beson sa duhet në vetvete, apo vazhdon të dëgjosh akoma dashakeqësit? Vetëm dëgjon vazhdimisht, që futu në Forever, por akoma nuk e ke vendosur? Deri kur? Më vonë që të jesh pensionist, me më shumë kohë? Ti e ke gjetur këtë? Urime....

Kujdes, se kohën as nuk mund ta ndalosh, as nuk mund ta mashtrosh! Për disa orë, për disa kohë, mund t'ja mbushësh mendjen vetes, që për ty është mirë, kështu siç është, por pastaj do të jesh i pakënaqur me të tjerët, që për faj të tyre ke një jetë të keqe dhe të pajetueshme. Do të dëshiroja të të qartësoja, që jeta jote është ashtu siç e bën ti. Së fundi dikujt duhet ti hapen sytë, e nesërmja të pret ty. Ti nuk je "i tillë". Përse, unë jam i tillë, Rexi, Miki Berkics, Attila Gidófalvi apo Veronika Lomjanski kanë lindur foreversa? Askush nuk ka lindur i këtillë apo i atillë, por çdo ditë preokupohen me atë, që t'ju mbushin mendjen, në raste të vështira si ti, që ka ardhur momenti për tu nisur... Sepse do të kesh një të ardhme, që do t'ju jesh mirënjohës për të.

Këto ditë isha në Serbi, dhe edhe atje, e përjetova atë, që jemi gjithnjë e më shumë, të cilët e ndjejnë këtë zjarr. A je nderur tashmë me të vërtetë, a të ka goditur tashmë me të vërtetë zjarri i aloes? Sigurisht, deri tani je nderur disa herë, edhe tani mundohesh, që të mund të paguash faturat, por a e ke menduar, se si mund të zgjidhet kjo edhe në mënyrë tjetër, apo mbetet birra dhe televizori...

Më në fund mendo për të ardhmen tënde, për fëmijët e tu, për dashurinë tënde, për forcën e pranverës dhe hiq një vijë: fund, do të vazhdojë një botë e re, bota jote, festojnë për ty, je plot me para, shpërthen nga shëndeti, je i suksesshëm dhe i lumtur. Hajde, vepro, mos u dorzo, mos dëgjo të tjerët, por vetëm sponzorin tënd! Dikush të thotë jo? Pastaj? Po ti për sa kohë the jo? Tani, edhe ty të vjen keq për ata? Para një jave edhe ti mendoje ndryshe.... Duaji njerëzit, ska rëndësi se çfarë janë, sepse sot ka mundësi, që të jenë pjesë e një bote tjetër, por nesër së bashku do të ndërtoni të ardhmen më të bukur, Shtetin e Foreverit të buzëqeshur. Le të jetë ky shteti ynë, ekzistenca jonë, e nesërmja jonë e mrekullueshme!

Me dashuri dhe me respekt:

Dr. Sándor Miliesz
drejtor i përgjithshëm



„LE TË KESH NJË GUR STARTI, NGA DO TË NISESH, DHE NJË OBJEKTIV, KU DO TË SHKOSH: PËR KËTË BËN FJALË SEMINARI NË ÇDO KATËR MUAJ" - THA DHËNËSI I EMRIT, PËR TRAJNIMIN DIAMANT TË FOREVERIT MIKLÓS BERKICS DIAMANT MENAXHERË. ME KËTË RAST DO TË LEXONI PJESËN E DYTË TË PËRGATITUR NGA TAKIMI I SHKURTIT.



BERKICS MIKLÓS
FOREVER DIAMANT

ATTILA GIDÓFALVI DIAMANT MENAXHER

Attila Gidófalvi me të shoqen, Katin është distributori që zë vendin e tretë në botë - me më shumë se 14 mijë pikë. Krahas Hungarisë drejton biznes të madh në Ukrain, Kazakistan dhe Rusi. Ai thotë: "Çfarëdo që të ndodhi me ty, duhet të mësosh që atë ta kthesh në të mirën tënde."

„Në 2008-ën fillova biznesin në FLP, dhe me qënë se mua nuk më thanë që ka krizë, pata sukses. Sot xhirua ime është sa dyfishi i asaj të rajonit, ndërsa bëra vetëm një gjë: kërkova ata persona, me të cilët punët mund të bëhen më mirë. Mos harro: ti je më i rëndësishmi, çdo gjë nëpërmjet teje ngrihet apo falimenton, sepse flet me zë më të lart, ajo që bën, se sa ajo që thua. Njerëzve duhet tu tregosh shembullin tënd. Nuk ka nevojë që të jesh vetë shumë i zgjuar. Mjafton, të më dëgjosh mua me vëmendje, dhe ata të cilëve ju funksionon. Unë nuk i kërkoj njerëzit, nuk kam nevojë, që të shes veten. U bëra diamant në atë mënyrë, që nuk ftova njeri, por më kërkojnë mua për faktin, se si e përfaqësoj kompaninë. Prandaj kam biznes të mirë, sepse njerëzit mendojnë për mua, atë që mendoj unë për veten. Pra, dua je veten, puno për atë, që të të duan edhe të tjerët. Bëhu ti motori i biznesit tënd: kopjohet ajo, çfarë je. Nëse do të merresh me veten, lexon librat, do të marrësh pjesë në të gjitha takimet dhe mban lidhjen e duhur me linjën e sipërme, atëhere çdo gjë do të eci në rregull.

Puna është pjesa më e lehtë, pjesa mendore është më e vështirë: vendosmëria, trajtimi i përgjigjeve negative. Sepse do të marrësh më shumë jo se po dhe midis thënësve të po-s nuk do të jenë të gjithë të suksesshëm. Këtu funksionon një gjë: të bësh gjërat e duhura, dhe ti bësh shumë herë. Këtu ka nevojë për njerëz me shpirt të ndritshëm, të pastër, që duan të jenë të suksesshëm. Fiton ai, që sjell sa më shumë njerëz në seminare. Por gabimisht dëshiron të bësh dikë të suksesshëm, sepse atë e di vetëm për veten tënde. Duhet të përveshësh mëngët, sepse ka filluar një vit i ri, dhe objektivi vetëm atëhere është objektiv, nëse ai që e ka shkruajtur, edhe beson në të. Ky biznes fut para në xhepin tënd, por ne nuk mund të të shkruajmë listat, të të ftojme njerëz dhe të ëndërrojmë në vendin tënd. Ki një qëllim, planifiko jetën tënde, krijo kohën, dhe biznesi nuk ka mundësi që të mos funksionojë.

Kjo kompani është e mirë, paguan gjithmonë në kohë, të vlerëson, produktet janë të mira: unë këtu do dal në pension. Tani po ndërtoj biznes të ri po me atë qëndrim, sikur po e filloj tani. Duhet të dish: nuk jam më i mirë, e më i vëmendshëm, se ty, vetëm se unë vë në funksionim ligjin e numrave të mëdhenjë. Gjithmonë e kam ditur, që Diamanti është niveli im. Unë jam "Forever". Po ti a je "Forever"?



LONG TRAINING
BUDAPEST, 2014. 02.15-16.



**VEPRIMI SHËRON
FRIKËN, MBETET NJË
PYETJE: SA TË MËDHA
JANË ËNDRRAT E TUA?**

RÓBERT VARGA DHE TÍMEA-HORTOBÁGYI VARGA DIAMANT-SAFIR MENAXHERË:

Róberti pothuaj u nis nga zerua, me vështirësi ekonomike serioze, por nuk dha dorëheqje nga lufta. Nga ajo kohë gjeti edhe shoqen ndihmëse në personin e Tímeas. Është baba i lumtur, por krahas fëmijëve është krenar edhe për grupin e tij.

„Ka nga ata, që nuk vijnë nëpër takime, dhe nuk e dinë kurrë, se çfarë kanë lënë. Jo vetëm nga kjo ditë, por edhe nga rradha e mundësive. Sigurisht shpesh herë krahas fëmijëve është e vështirë të jetosh edhe për punën tonë, por tek ne pikërisht fëmijët janë motivuesit më të mëdhenjë. Vetëm nga ne varet, që a e lejojmë veten të ngadalësohemi apo të ndalojmë, për të parë mundësitë. Kemi rezultate të mira, por si të gjithë edhe ne ja kemi paguar çmimin, bile, mund të mos jesh i lumtur edhe i pasur. Në këto raste, brenda nesh e mban shpirtin, nëse do të kemi një vizion, dhe e dimë, që ne e meritojmë këtë. Sepse njerëz, që duan të jetojnë të shëndetshëm dhe që duan të fitojnë sa më shumë para ka me shumicë, kështu që ka zgjidhje. Nuk duhet të harojmë as atë, që nuk je vetëm: kompania u zgjerua edhe gjatë krizës. Sot pjesa më e madhe e njerëzve prandaj nuk janë të lumtur, sepse nuk drejtojnë ata, por atyre ju thuhet, se çfarë duhet të bëjnë. Bashkë me këtë është e pasigurt e ardhmja. Por në këtë botë biznesi FLP-ja është pikë stabil. Veprimi shëron frikën, mbetet një pyetje: sa të mëdha janë ëndrrat e tua? A ka diçka, për të cilën ja vlen të zgjohesh dhe më pas të kujtohesh me krenari për të?

ISTVÁN HALMI DHE RITA MIKOLA HALMINÉ DIAMANT-SAFIR MENAXHERË:

Çifti i bashkëshortëve ka marrë pjesë si në të qënurit të punësuar ashtu edhe në atë si sipërmarrës. Pamvarësisht nga rrethanat, gjithmonë ishin të aftë tu përshtateshin atyre, dhe nëse duhej, të punonin të sforcuar. Ndërsa sot kanë një qëllim të përbashkët - dhe ai është - që bashkë me familjen – ata janë të lidhur me ndërtimin e rrjetit.

„Ka çifte, ku palët nuk ecin në të njëjtin drejtim. Atyre ne ju themi: ta mendojnë mirë jetën e tyre, se ku i çon kjo rrugë. Ne njëherësh vendosëm, që të themi po për biznesin, dhe pas nivelit Soaring erdhi Safiri, më pas Diamant-Safir: gjithmonë për rezultatet e njerit apo tjetrit person, dhe në gjurmën e premtimit që i është bërë atij. Cilësia e jetës tonë dhe e një njeriu të zakonshëm... është komplet tjetër, e cila varet prej asaj, se me cilët rrethojmë veten. Sa ndryshe do të jetë bota, nëse të gjithë njerëzit do të mund të mësonin nëpër këto seminare! Nëse të rriturit do ta ngrinin njëri-tjetrin, dhe nuk do ta shtypnin! Të mos duam një normalitet të zbrazur! Foreveri nuk është vetëm punë, por edhe mjet, për ta ndryshuar jetën në atë mënyrë, që as të qënurit i punësuar dhe as të qënurit si sipërmarrës nuk ka mundësi ta bëjë. Foreveri jep unitetin, dhe me atë shkojmë në ato vende, për të cilat kemi menduar vetëm në ëndrrat tona më të guximshme. Me ne është djali ynë i madh, dhe së shpejti edhe i vogli.“

**FOREVERI NUK ËSHTË
VETËM PUNË, POR EDHE
MJET, PËR TA NDRYSHUAR
JETËN NË ATË MËNYRË**



ARANKA VÁGÁSI DIAMANT-SAFIR MENAXHERE

Bazën e vendosmëris së Arankës e ka krijuar karriera si sportiste aktive. Sot drejtuesja karizmatike së bashku me të shoqin András Kovács drejton një grup të madh. Beson në punën e përbashkët dhe në forcën e familjes.

„Cili është sekreti i suksesit? Është e thjeshtë: bashkpunimi në familje, angazhimi, zelli, shokët e shumë të mirë, pranimi i dështimit, kreativiteti, tempua e mirë e punës dhe qëllimet e përbashkëta. Të gjithë luftëtarët e mëdhenjë marrin plagë, kush nuk merr, ai vetëm e planifikon luftën. Duhet zgjuar, se përndryshe njeriu nuk përparon. Të guxojm të mendojmë në sipërfaqe të mëdha, dhe jo vetëm deri tek komshi! Në vend të largjes së trurit, sot më në fund di të mendoj me mendje të pastër, dhe tashmë e di: pengesat prandaj janë, që ti kapërcejmë ato. Ndonëse as si femër sportiste nuk është e lehtë të qëndrosh në këmbë në ndërtimin e rrjetit, e të rinovohesh, prandaj i uroj të gjithë ata që nuk janë dorëzuar! Merr atë vendim, që të çon në vendin më të mirë, aty, ku e meriton! Duhet provuar, dhe nuk duhen kërkuar pretekstet. Që këto përvoja të mund t'ju a japim më tej fëmijëve tanë, duhet të luftojmë dhe të sforcohem në të gjitha rrethanat.



**TË GJITHË
LUFTËTARËT E
MËDHENJË MARRIN
PLAGË, KUSH NUK MERR,
AI VETËM E PLANIFIKON
LUFTËN.**

MIKLÓS BERKICS DIAMANT MENAXHER

Dhënësi i idesë dhe drejtuesi i takimit punon në biznes që nga viti 1997. Brenda dy vjetëve u bë menaxher, në 2007-ën Safir, në 2011-ën Diamant menaxher. Ai është një njeri i tillë, në të cilin nuk sollën ndryshime suksesi i madh dhe paratë.

Gjithmonë është në qejf, dhe ndihmon gjithmonë ata, që shkojnë në rrugë pas tij.

„Çfarë biznesi do, të vogël apo të madh? Ti do ta vendosësh, por më dëgjo me vëmendje, për top 10, për top 5, apo për Diamant. Nëse do para, atëhere mendo ndryshe, ngrihu, vepro dhe mos prit për sponzorin. Me atë vetëm duhet konsultuar, dhe të të tregojë rrugën, pra merr në dorë jetën tënde! Le të jetë ky viti i rinovimit të plotë! Kush është ai, që do të marrë pjesë në rritjen prej dhjetë mijë pikësh që pritet? Te cili shikon të ardhmen e biznesit? Mos harro: me ata njerëz që do të rrethosh veten për pesë vjet, si mesatarje e tyre do të shndrohesh. Morrëm fjalkalimin: feeling better - looking better, ose: ndjenjë më e mirë - pamje më e bukur. Programin C9 nuk është e lehtë ta bësh deri në fund, por ja vlen, sepse mendimet tona kanë efektin më të mirë në biznesin tonë - ashtu si dhe përvoja me produktet. Si C9 ashtu dhe Vital5 pothuaj i prodhojnë vetë bashkpuntorët. Përparojmë hap pas hapi, ndërsa në Londër na pret edhe një surprizë. E meritojmë: për shtatëmbëdhjet vjet kemi përfunduar një punë shumë të mirë, por ky është një treg në ndryshim të vazhdueshëm. Bazat janë po ato, por ne ndërkohë ndryshojmë sikurse edhe këndvështrimi. Njihu me planin marketing dhe nisu: kjo do të jetë e ardhmja. Nuk do të ndjehesh mirë, nëse do të jesh ziliqar për sukseset e të tjerëve, gjithmonë mbushu me lumturi, kur shikon dikë në podium, sepse ai punon edhe për ty.

Turbo Start, Go Diamond... nuk është e sigurt, që pikërisht këto janë seminarët e tua, por çfarë ndodhë, nëse po, dhe ti nuk je aty? Nuk është e sigurt, që secili do të shkojë nga seminari si njeri tjetër në shtëpi, por ti nga nesër mendo ndryshe! Ndërsa "të rinjve" ju bëj mesazh: tani do të pasojnë muajt e tyre: në Ditën e Sukselit më të afërt mund të ngjiten në podium. Po nga ato qeliza jeni bërë, si çdo Diamant, po ai ndërtim truri është si i Ainshtainit, i Edisonit, apo i njerëzve më të pasur në botë. Nëse ke mundësi të prekësh zemrën e dikujt, atëhere nuk ka kufi. Në 1978-ën Rex Maughani gjeti një mjet, me të cilin mund të prekësh zemrën e njerëzve Ata që janë aq të çmendur, sa që mendojnë, se mund të ndryshojnë botën, ata edhe e bëjnë. Ne ju treguam, se për çfarë dhe si duhet ta përdorni trurin. Le të jetë i yti ky takim!

**NËSE
DO PARA,
ATËHERE MENDO
NDRYSHE, NGRIHU,
VEPRO DHE MOS PRIT
PËR SPONZORIN.**



SMILJAN MORI



„Nuk ka rëndësi ajo
çfarë ndodh me ne,
por ajo çka mësojmë
prej ndodhisë”

Çdo fjalë e imja bazohet në eksperiencën time dhe në atë që kam provuar. Një njeri, një libër, një fjalë, një thënie, një seminar mund të ndryshojë edhe jetën tënde. Nuk është e rëndësishme ajo që do të them unë, por si do ta dëgjoni ju. Dhe kryesisht: çfarë do të bëni me ato që unë them.

Mendoj se njeriu, merr atë që kërkon, atë që do, atë për të cilën ka dëshirë. Forca më e madhe ndodhet midis dy veshëve: vetëdija, sepse tashmë është një fakt i garantuar, që realitetin mund ta ndryshojë mënyra jonë e të menduarit. Por sa herë ka ndodhur që kemi menduar pozitivisht, megjithatë nuk kemi mundur të arrijmë atë që kemi dashur!

Gjithmonë mendojmë se ka ndonjë shkak të jashtëm për dështimin, kur e vërteta qëndron ndryshe. Ndoshta nuk kemi gjetur njeriun e duhur, nuk kemi njohuritë e duhura apo sigurinë e duhur. E vetmja gjë që qëndron para rrugës tuaj: është ajo se çfarë mendoni për biznesin. Është pak ajo që duam me vetëdije, edhe vetëdijen tonë të brendshme duhet përsëri ta programojmë. Vendimi ka rëndësi. Çfardo do që dëshirojmë në jetë, së pari duhet ta përcaktojmë – këtu qëndron fuqia. Mjafton një vlerësim i vogël, që për 10-15 vjet të mund të bëhesh i madh.

Kurrë nuk i arrin kufijtë e tu – kufij të tillë nuk ka, ato nuk mund ti arrish kurrë, sepse dijet dhe përvoja i zgjerojnë këta kufij. Gjëja e parë është: mos u përpiq të ndryshosh mjedisin, por mënyrën tënde të të menduarit, ndjenjat e tua. Duhet të bësh gjëra të tjera, në një mënyrë tjetër. Është gjë e vështirë, sepse është „programuar” thellë brënda nesh, që nga moshja jonë e vogël. Program është gjithshka që ne themi, që ne bëjmë. Prandaj ndiqeni me vëmendje atë se çfarë flisni, me kë bisedoni, çfarë shikoni dhe çfarë lexoni: e gjithë kjo ndikon në mënyrën e të menduarit.

Një këshillë e thjeshtë për atë si mund të arrish nivelin Diamant: mos shiko televizor! Mua nuk më interesojnë lajmet, më interesojnë vetëm lajmet e mija. Im atë më thoshte, çdo gjë është e mundshme, në qoftë se punojmë për të dhe në qoftë se atë e duam. Po të kemi endërra gjithshka mund ta arrijmë. Dikur as unë nuk do ta kisha menduar që do të kisha firmën time, që do të shkoja nëpër botë dhe të zhvilloj bisedime me miliarderë. Duhet besuar dhe adhuroar objektivat e tua, ti pasqyrosh dhe ti rrenjosësh në mendimet e tua. Por duhet ditur edhe ajo, pse do ti arrish, edhe sikur të jenë për shumë arsye! Për mua ishte mungesa e dashurisë: për këtë luftova gjatë jetës sime. Por diçka mësova: mos e bën diçka, sepse do të marrësh diçka nga të tjerët. Kërko ato rezultate që ndodhen brënda teje. Duhet që diçka ta kesh pasion, që jep vrull, diçka të re që duhet ta provosh.

Njerzit në botë janë kudo njëlloj: të gjithë duan të jenë të pasur dhe të shëndetshëm – për këtë mund të besosh. Ndërsa mendimet negative që shprehen rreth teje, thjeshtë jepu një të fshirë!

Leksionet e mija të para thujse askush nuk i kishte dëgjuar, por unë imagjinova publikun, dhe qindra vetë u afruan më shumë: që më bëri të imagjinoja, ajo u realizua. Sa hapa bëjmë drejt objektivit aq

bën edhe objektivi drejt nesh. Unë në vend të fjalës motivim përdor fjalën motivaksion. Sepse pavarishtë nga cila pikënisje fillon, vetëm atëhere ka kuptim vërtet, në qoftë se lëvizim në drejtim të objektivit. Çështja shtrohet në se mbas seminarit a do të ketë veprim. Sigurisht as unë nuk jam gjithmonë gazmor, optimist, edhe unë kam minutat e mia të errëta. Por nuk ka rëndësi ajo çka ndodh me ne, por ajo si e përjetojmë, çfarë mësimesh nxjerrim dhe çfarë vendimi marrim. Mos u fokusoj në atë çfarë nuk je, në atë që nuk mundesh, por në atë që ke mundësi. Në qoftë se do të ndryshosh jetën tënde, fillo të mendosh, të ndjesh, të lëvizësh ndryshe, mbasi edhe mimika jote, dhe trupi yt flasin, dhe si ndikon ti tek tjetri, edhe ai ndikon në të kundërt

tek ti. Biseda kokë më kokë ka forcë. Në qoftë se nishesh për dikë, nuk është njëlloj si të nishesh për atje me mëdyshje apo duke dashur diçka. Tashmë lëvizjet e tua, mund ti bëjnë relative vështirësitë. Nga çfarë ke frikë përpara? Trishtimi dhe frika në ditarin tim zënë vetëm 5 minuta... Babai më thoshte gjithmonë: „ji normal“. Dhe unë ashtu isha si gjithëkush rreth meje. Por në faturën time kisha një minus jo normale.

Lektori star i Trainimit të Miklós Berkics ishte konsulenti dhe biznesmeni sloven Smiljan Mori, një nga motivuesit më impulsiv në botë. Nga leksionet e tij në 50 vende të botës kanë ndryshuar mënyrën e jetesës më tepër se 150 mijë njerëz.

Dhe kam kuptuar, se në qoftë se dëshiron të arrish diçka në jetë, nuk duhet me qënë „normal“. Në qoftë se dikush më pyet, sipas meje çfarë mendojnë të tjerët për mua, unë u përgjigjem: kujt i intereson? Fatkeqsisht njerzit janë egoistë, duke dashur të jenë më të zgjuar, më të bukur dhe më të mirë se të tjerët. Por nuk e dinë se në këtë mënyrë të tjerët i shtyn më poshtë. Pengesa më e madhe për të arritur objektivat tuaja, është kur merreni me atë se çfarë mendojnë të tjerët për ju. Merruni më mirë me atë, se çfarë mendoni ju për veten tuaj, dhe dëgjoni vetëm sinjalet e kundërta pozitive!

Shumë herë nuk kemi përpara mure, por vetëm mendime që na pengojnë. Nuk duhet të kemi frikë, kur një Diamant nuk ka frikë, as ne nuk duhet të kemi.





SHËNDETI NË RROKULLIMË

Kontrolli mjekësor shpëton jetën



725 qendra

mbi 2000000

kontrolle mjekësore

bilanci i 4 viteve

Në shtatëqind e njëzet e pesë pika, mbi 200 milion kontrolle mjekësore, të dhëna dramatike, ky është bilanci i katër vjetëve të programit të kontrollit shëndetsor të popullsisë hungareze. Qëllimi i kësaj inisiative është ruajtja e shëndetit, parandalimi i sëmundjeve . Analizat e kryera në kuadrin kompleks të njohjes të gjëndjes, gjithmonë varet edhe nga individit, por në tërësi kërkojnë gjysëm ore.





Duke shikuar gjëndjen e përgjithshme shëndetsore në Hungari, në raport me botën qëndrojmë në „vend të dalluar”. Vdekshmëria e përgjithshme 54% nga problemet e zembrës dhe të sistemit të venave, ndërsa 27% nga tumoret. Të pakzën 3 milionë vetë janë me tension të lartë, një milion me diabet, ndërsa 40% e popullsisë janë me mbipeshë. Krahasuar me mesataren e BE njerzit tanë pijnë më shumë duhan dhe konsumojnë më shumë alkol, dhe shumica bëjnë një jetë inaktive, pa lëvizje. Mosha mesatare e popullsisë hungareze është nën mesataren e Bashkimit European, dhe në vitet që shkuan numeri i popullsisë hungareze ka rënë nën 10 milion.

Duke patur parasysh këto të dhëna, në interes të përmirësimit të gjëndjes shëndetsore, në 2010 nisi „Programi i ruajtjes të shëndetit 2010-2020 për Hungarinë”, që përfshin 56 organizata që kanë të bëjnë me shëndetin, që deri në vitin 2020, nëpërmjet një qendre kontrolli të lëvizshme njëzet metra të gjatë, duke kaluar nëpër të gjitha qendrat e banuara do të bëjë një kontroll të përgjithshëm të gjëndjes shëndetsore të popullsisë hungareze.

Programi deri tani është kryer në 725 qendra, duke përshkruar 85 545 kilometra rrugë, me përfshirjen e 1 077 specialistëve të mjekësisë, me 2 266 337 kontrolle të kryera, të kthyer në orë preventive 6711, dhe duke pritur 194 549 vizitorë.

Objektivi i programit edhe në të ardhshmen mbetet i pandryshuar: ai edhe më tej dëshiron ti japë mundësi popullsisë që të bëjë hapin e parë për përmirësimin e shëndetit. Sipas mendimit të komisionit special dhe atij të koordinimit, ka shumë rëndësi që njerzit të ballafaqohen me gjëndjen e tyre shëndetsore, dhe po që e nevojshme të ndryshojnë edhe mënyrën e tyre të jetesës. Edhe të dhënat statistikore jo të mira, vërtetojnë se ka shumë nevojë për niasativa të tilla, dhe që sa më shumë vetë ta ndjejnë se duhet të kujdesen për shëndetin e vet dhe të familjes së tyre, dhe ti mirëpresin mundësitë e dhëna nga ky kontroll i përgjithshëm.

Programi i kontrollit të përgjithshëm shëndetsor edhe për vitin 2014 parashikon kontrollin e gjëndjes shëndetsore në 200 qendra, duke arritur që me dhëmbën kontrollit modern shëndetsor, si dhe me një mënyrë jetese të shëndetshme, të theksohet rëndësia e parandalimit dhe edhe më tej të mund të bëhet më shumë për ruajtjen e shëndetit të popullsisë dhe në fushën e zhvillimit të tij. Informacion më i plotë për programin mund të gjendet në faqen e internetit www.egeszsegprogram.eu.

Hollësitë e mësipërme u përzgjedhën nga Forever Living Products Shpk si partnere strategjike e këtij programi, duke i marrë nga komunikata për shtyp e datës 5 mars 2014 e prof. dr. István Kiss, kryetar i komisionit të specialistëve dhe drejtuesi i programit Gergely Dankovics. Komunikata e plotë për shtyp mund të gjendet në faqen tonë të internetit : https://www.foreverliving.com/marketing/Page.do?name=local_events#health



SUCCESS DAY Opatija



Dita e parë e Suksesit e FLP Kroaci për këtë vit u organizua në Opatija që notonte në dritën e diellit. Salla e kongreseve të Hotel Ambasador ishte mbushur plot me bashpunëtorë që donin të mësonin dhe miqësoheshin. Dhe se si takimi ynë të bëhej më festiv dhe më gazmor u kujdes drejtuesi i programit Dr. Albert Keresztényi

– Senior menaxher, mbasi festonte pikërisht ditëlindjen. Pas parakalimit në skenë të menaxherëve, drejtuesin e programit e përshëndetëm me tortën e ditëlindjes duke kënduar „Happy birthday“. Dhe Alberti e meritonte këtë falnderim. Ai ka hedhur bazat e FLP të Kroacisë, në kushtet më të vështira. Kur ai filloi të punonte, në Kroaci nuk ekzistonte asgjë. As zyrë, as produkte, as literaturë. Të qëndroje me FLP në atë kohë do të thoshte guxim dhe sfidë.

Alberti i prekur nga surpriza falnderoi bashpunëtorët që ishin prezent dhe pastaj ftoi në skenë drejtuesit e zyrave të Kroacisë Dr. László Molnár, dhe Andrej Kepé. Dr. László Molnár theksoi se rritja e xhiros prej 32 përqind është më e madhja në Europë. Pas kësaj thirri në skenë miqtë e dashur nga Hungaria, Dr Sándor Milesz – drejtor i rajonit dhe Péter Lenkey menaxher i pergjithshëm. Dr Milesz pas fjalëve të përshëndetjes, theksoi rendësinë e lirisë. „Të jesh i lirë, është një vlerë e paçmuar.“ Të jemi të lirë dhe të ecim në rrugën tonë. Dhe FLP na ofron pikërisht lirinë financiare, mundësinë e punës të bërë për dobinë e vet. Péter Lenkey foli për distributorët kroatë duke u shprehur atyre falnderime të veçanta. Rezultatet e Kroacisë i janë vënë re tashmë jo vetëm në rajon por edhe në Europë. Péter Lenkey na garantoi për mbështetjen e plotë nga drejtuesit e firmës, duke na nxitur që të ecim edhe më tej në rrugën e nisur, ndërsa rezultatet do ta tregojnë me siguri të plotë se ky sukses nuk është i rastësishëm, por rezultat i një pune të mirë dhe plot sakrificë.





Lektori ynë i parë ka ardhur nga Slovenia: nga Dr Miran Arbeiter - Senior menaxher, dëgjojmë një leksion të shkëlqyer mjekësor për diabetin. Na bën të njohur, si lind, çfarë simptomash ka dhe në sa lloje është. Në fund të leksionit Dr Arbeiter na tregon edhe atë që në luftën kundër kësaj sëmundje të rëndë çfarë ndihme mund të marrim.

Pas kësaj vazhdoi leksioni i menaxheres të sapo kualifikuar Brankica Lukanić. Na tregoi historinë e saj se si arriti të bëhej menaxhere. Foli për qëndrimin fillestar negativ dhe për pasigurinë e saj dhe për atë se si filloi të punoi me durim në sajë të sponsorve të saj. Brankica dhe bashkëshorti i saj janë sipërmarrës, kanë firmën dhe punonjst e tyre, por tek FLP shikojnë mundësinë që të angazhohen me atë që u pëlqen dhe të ndihmojnë edhe të tjerët për një cilësi më të mirë jetese dhe për arritjen e pavarësisë materiale.

Brankica falnderoi bashkshortin e saj, Žarko, për ndihmën e dhënë dhe vajzën e saj të vogël për durimin e saj.

Daniel Štajdohar është anëtar i valëve të reja të FLP. Skuadra e tij ka vënë në lëvizje Kroacinë Veriore, duke treguar se nuk është kurrë vonë të lidhesh me FLP dhe ti futesh rrugës që të çon tek suksesi. Danielin dhe skuadrën e tij e kanë motivuar takimet e mëdha të Budapestit dhe ato të Ditëve të Suksesit. Këto trainime u japin përgjigje shumë dyshimeve, me të cilat ndeshemi në fillim të punës sonë. Shumë pyesin: a ia vlen puna e tij? Por edhe më të sukseshmit e kanë bërë këtë pyetje në fillim. „Ju jeni personat e duhur, sepse sot jeni këtu, pse ju intereson. Filloni të besoni tek vetja dhe ndiqni sponsorit tuaj! Qëndroni midis nesh për kohën e mjaftueshme dhe do ta shikoni se endërrat tuaja do të bëhen realitet!”

Pas kësaj vazhdoi dueti Helena dhe Ivo. Helenën e FLP të qytetit Pula, mund ta kujtojmë fitoren e saj si Miss Sonya. Bashkë me partnerin e saj na kënduan disa këngë të bukura dashurie.

Pas pushimit dhe një blloku tjetër muzikor, vazhdoi leksioni i përbashkët i çiftit të lidhur në Porec, Sandra dhe Matija Jagodin. Cili është realiteti? Halli apo mundësia. Kush ndikon tek individit dhe tek shoqëria në përgjithësi? Si mund të ndihmojë FLP në rrugën e daljes nga kriza dhe të mund të gjesh zgjidhjen? Gjith këtë mund ta mësojmë nga leksioni i Sandras dhe Matijas. Në fund të leksionit të tyre ata falnderuan sponsorit dhe bashkpunëtorët e tyre, dhe dhanë mesazhin: „të mos zgjedhim drejtimin e erës, por gjithmonë të mund të shtërngojmë velat e anijes sonë”.

Erdhi përsëri momenti i vlerësimit të punës të bashkpunëtorëve të sapo kualifikuar. Pas kemi muajin mars dhe fillimin e vitit.

Nga janari deri tani u pasuruan me 20 supervizor të rinj me 5 çifte asistent menaxherësh dhe po me kaq menaxherë. Rezultat i jashtzakonshëm. Përgëzime të kualifikuarve, sponsorve dhe bashkpunëtorëve të tyre!

Nga leksioni i shkëlqyer i Nenad Pavletić mundëm të mësonim: pse pikërisht FLP? Ka mijra arsye. Neno na përmend vetëm disa prej tyre, duke na i zbuluar me arsye të bazuara: çmime të pandryshuara prej shumë vitesh, bonuset dhe të ardhurat financiare të llogaritura në euro, cilësi e qëndrueshme e produkteve, zgjerim i vazhdueshëm i gamës të produkteve. Pa çmim regjistrimi





apo anëtarësimi në firmë, me nivel menaxhimi të arritur një herë që nuk hiqet më, me mundësi ndërtimi të biznesit në të 150 vendet e botës ku vepron FLP. Me shumë programe stimuluese. Një firmë që vepron në treg mbi 35 vjet dhe gjithmonë në rritje. Të gjitha këto janë vlera të paçmuara.

Pas kësaj vazhdon prezantimi i të kualifikuarve për stimulin e veturës dhe të +60 pikëve për muajt janar, shkurt e mars si dhe i të kualifikuarve të Global Rally-t të Londrës dhe të Holiday Rally-t në Opatija. Faktikisht ka shumë të kualifikuar, dhe tek secili prej tyre në tribunë shikojmë fytyra të gëzuara.

Tihomir Stilin dhe bashkshortja e tij, Maja janë bashkpunëtorët më të sukseshëm të FLP Kroaci. Në Kroaci janë fituesit me më shumë pikë të stimullit të Global Rally-t. Ata kanë grumbulluar mbi 2500 pikë. Tihomir nuk ka qejf të flas para publikut të madh. Ai është një drejtues i tillë, që me sicilin bashkpunëtor angazhohet individualisht, duke patur edhe ndihmën efektive të Majës shumë të duruar. Në ditën e sotme shfrytëzoi mundësinë për të falnderuar bashkpunëtorët e tij, çiftet Pavletić dhe Jurović. Edhe ata i përkasin skuadrës të tij dhe kanë kontribuar në rezultatet Tihomirit dhe Maja-s për të arritur në majë dhe të jenë midis më të sukseshmëve.

Distiktivi i shqiponjës merret kur ngjitet shkalla e parë e marketingut, duke u bashkuar në fluturimin e më të sukseshmëve. Në Ditën e sotme të Suksesit këtë distiktiv mundën ta marrin mbi 100 bashkpunëtorë. Skena ishte pak e vogël që ti nxente të gjithë ata që festuan kualifikimin e parë të tyre. Shpresojmë se leksionet e sotme dhe shembulli i më të sukseshmëve do ti motivojnë ata për rezultate të mëtejshme dhe në të ardhmen e afert ti shikojmë ata të kualifikuar në shkallë më të larta. I urojmë ata për suksesin e tyre.

Në fund të ditës së suksesit, një leksion interesant na mbajti Sonja Jurović me titullin: „Sonja ShA apo FLP?“ Çfarë mundtësisht të japin firmat private, dhe kryesisht kur e merr fitimin? Sa duhet të punojmë në firmë dhe sa mund të fitojmë prej saj, kur vetëm një pjesë të vogël të fitimit marrim? Në leksionin e saj Sonja pyet: „Pse e lejoni, tua përcaktoj unë çfarë duhet të bëni dhe me kë të punoni, kur këtë mund ta bëni edhe pa mua? Merrni vendimin e duhur dhe falnderoni FLP për mundësinë që ju ofron!“

Mbas falnderimit të drejtuesit të programit, lektorëve dhe miqve të ardhur, drejtori rajonal i FLP Kroaci, Dr László Molnár, na ftoi të marrim pjesë në trainimin Start që do të organizohet më 29 Mars 2014, në Hotel Panorama të Zagrebit dhe po aty në Ditën e Suksesit më 10 Maj 2014.

Dr László Molnár
Drejtor rajonal i FLP Kroaci



Vetëm kliko në magic:

www.flptv.hu



FLPTV tashmë prej 6 muajsh është rinovuar rrenjësisht, duke i pritur shikuesit me një faqe web krejt të re. Dëshirojmë tu plotësojmë dëshirat edhe atyre që nuk kanë qënë vizitor sistematik në shikimin e tij.

Personalei ynë ka vënë re, se edhe që nga rinovimi i gjashtë muajve më parë, numeri i shikuesve është rritur jashtzakonisht shumë, por akoma faqen tonë jo çdo distributor e sheh rregullisht. Shumë frenohen vetëm se ndoshta nuk janë përdorues të përsosur të kompiuterit, apo thjeshtë nuk kanë dëgjuar mjaft për televizionin tonë. Prandaj

tashmë për shikuesit ekzistues dhe ata të mundshëm ju shërbejmë me disa këshilla praktike.

Ajo që është më e rëndësishme për tu ditur: FLPTV është një televizion në internet i firmës Forever Living Products, posaçërisht për shikim on-line në faqet web. Domethënë trasmetimi ynë mund të shikohet kudo dhe kurdoherë gjatë njëzet e katër orëve. Theksojmë se falë zhvillimeve tona, ai mund të shikohet gati me çdo mjet, qoftë kompiuter tavoline, laptop, apo edhe celular.

Si mund të na gjeni ne? Mjafton të shkruani në kompiuter www.flptv.hu dhe ai ju shfaqet në faqen tonë të internetit. Por në qoftë se dikush shfrytëzon kërkuesin Google, edhe ai mund ta gjejë lehtë, në qoftë se shkruan flptv. Duke filluar prej këndeje, tanimë duket faqja jonë aktuale fillestare. Sipër, në krahun e majtë të ekranit, kalojnë automatikisht njëri pas tjetrit titujt e programit.

Në informacionin e mësipërm, duke klikuar FLP Hirek mund të shikohet programet tona sipas orëve të shfaqjes – në krye ato më të freskëtat, ndërsa më poshtë videot e programeve më të hershme. Natyrisht këtu mund të gjenden edhe materiale më të hershme, regjistrime të përgatitura gjatë tre vjetëve të fundit në Ditët e Suksesit, në kualifikime, në leksione e trainime të ndryshme, si dhe programe të veçanta të prodhuara prej nesh, biseda në studio etj nën titullin Archívumban. Edhe kjo mund të gjendet në ikonat e sipërme.

Lart, në qoshen e djathtë të ekranit, që duket vazhdimisht, në mënyrën e veçantë të botës së televizioneve në internet, mund të shikohet programi live që ndryshon vazhdimisht gjatë njëzet e katër orëve me materiale të FLPTV. Ajo që e bën më simpatik, krahasuar me strukturat e televizioneve tradicionale, është ajo që aty mund të njoftohet lista e programeve që mund të shihen nga ora në orë.

Shpresojmë që kjo tu ngjallë interesimin edhe atyre nuk i shikojnë ose i shikojnë rrallë programet tona.

**Sándor Berkes – drejtues i studios
dhe Dr Tamás Karizs – kryeredaktor**

2.04 „PIKË CC”

(h) Pikë të Reja: konsiderohen pikët e distributorëve të linjës së poshtme të një menaxheri gjatë 12 muajve kalendarik (përfshi edhe muajin e regjistrimit), deri sa distributori i Ri të mos ketë arritur nivelin e menaxherit.

8.04 STATUSI I EAGLE MENAXHERIT

(a) 2) Të ketë grumbulluar të paktën 720 CC totale, duke përfshirë të paktën 100 CC të Reja.

(c) Të gjitha kërkesat duhet të plotësohen në një kompani ushtrimore të vetme, me përjashtim të kërkesës të Pikëve (CC) të Reja dhe të kërkesës për Menaxher Eagle të Linjës së poshtme, sikurse spjegohet më poshtë.

(d) Distributorët e Risponsorizuar përfshihen në kërkesat Supervisor të ri dhe për Pikët (CC) të REJA.

(e) Menaxheri mund të bashkojë Pikët (CC) e Reja nga vendet e ndryshme për plotësimin e kërkesës të 100 Pikëve të Reja.

(g) Në qoftë se një distributor arrin menaxher gjatë periudhës të kualifikimit:

1) Çdo distributor i Ri i sponsorizuar gjatë muajit të fundit të ngjitjes do të llogaritet si sponsorizim i ri dhe po kështu si plotësim i kërkesave për pikët e reja për atë periudhë kualifikimi të programit Eagle menaxher.

2) Kërkesat për Eagle menaxher nuk ndryshojnë; distributori duhet të plotësojë kushtin 720 CC të plota dhe 100 CC e reja si dhe të ketë siguruar kualifikimin e dy Supervisorëve gjatë periudhës që i ka mbetur mbas kualifikimit si menaxher.

11 CHAIRMAN’S BONUS

11.01 (b) Menaxher për Chairman’s Bonus të Nivelit të 1-rë

2)) ...përfshi minimumi 150 CC të Reja. Këto pikë të reja mund të sigurohen dhe mblidhen nga çdo vend. Megjithatë, pikët e reja të siguruar jashtë vendit të kualifikimit, nuk llogariten për përqindjen e stimujve.

(7) Distributorët e Risponsorizuar duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e Nivelit të 1-rë.

(c) Menaxherët për Chairman’s Bonus të nivelit të 2-të dhe të Nivelit të 3-të

2) përfshi 150 pikë CC të reja.

Këto 100 pikë mund të mblidhen nga çdo vend ose vende. Ato pikë të Reja që sigurohen jashtë vendit të kualifikimit, nuk llogariten gjatë përcaktimit të shumës të përqindjes të stimujve.

5) Edhe distributorët e Risponsorizuar merren parasysh lidhur me kërkesat e nivelit të 2-të dhe të 3-të.

6) Në qoftë se distributori arrin menaxher gjatë periudhës të kualifikimit, pikët e realizuara nga distributorët e rinj të sponsorizuar prej tij do të llogariten për kërkesën e pikëve të reja të Chairman’s Bonus.

(e) Llogaritja e stimulit Chairman’s Bonus.

2) Distributorit i kualifikuar do të shpërblehet në Përqindjen Stimuluese për të gjitha pikët totale të siguruar në vendin e kualifikimit (por jo për pikët e reja jashtë vendit të kualifikimit), plus Përqindjet Stimuluese të siguruar nga menaxheri i parë i Chairman’s Bonus për çdo linjë sponsorizimi të tyre në Vendin Pjesmarrës.

14 RISPONSORIZIMI

14.01 (c) Distributori i risponsorizuar fillon përsëri në nivelin e Distributorit të Ri poshtë Sponsorit të ri dhe humbet çdo linjë poshtë tij në të gjitha vendet deri në momentin e ndërrimit të sponsorit.

(d) Distributori i risponsorizuar, ka të drejtë si distributor i sponsorizuar i ri për të gjitha stimujt dhe promocionet

I dashur dëshirues për të mësuar!

„Kjo faqe interneti është destinuar për atë që me ndihmën e materialeve të shkëlqyera të trainimit të ekspozuara në këtë faqe të përvetsohet në mënyrë më të efektshme mjeshtëria e ndërtimit të rrjeteve, si dhe të ndikojë në punën tuaj si një forcë motivuese. Kjo mundësi e pashoqe siguron marrjen e lehtë të një numur informacionesh të tilla të cilat e bëjnë më të lehtë punën, sepse gjithmonë kemi nevojë për ide e teknika të reja, por edhe për disa fjalë frymëzuese. Kolegët tanë që zotërojnë njohuri të shkëlqyera profesionale, ju vënë në dispozicion materialet e leksioneve të tyre, prej të cilave mund të përvetsoni elementët me rëndësi jetike për ju. Me ndihmën e njeri tjetrit, me mësuarje u afrohem me shumë atyre objektivave të mrekullueshme, që nëbotë të veprojmë si një familje e madh, duke shërbyer si shembull për atë qëkjo punë nuk është gjë tjetër veçse një profesion, dhe ëndërrat për gjithkënd mund të bëhen realitet.

Të gjithëve ju bëjmë thirrje të të jetoni me këtë mundësi! Përpara FLP Hungari!

Dr. Sándor Milesz- Drejtor i Përgjithshëm

Faqja e trainimit në internet Forever Business School me tekstin e mësipërm falnderon vizitorin e saj, drejtorin tonë të përgjithshëm, Dr Sándor Milesz, i cili në emër të Foreverit, me skuadrën e tij e përpunon vazhdimisht që të japë dhe sigurojë çdo mundësi trainimi për një ndërtim rrjetesh të sukseshme.



Këtu do të donim që ndihma juaj të jetë në atë, që përdorimi i faqes së re të trainimit të jetë pa pengesa.

Ka raste kur në procesin e regjistrimit butonat nuk funksionojnë kur i klikon me kursor, por nuk reagon programi, ose nuk mundesh të klikosh atje. Në këtë rast ju propozojmë përdorimin e një programi tjetër (si për shembull Google Chrome, Firebox).

Mbasi realizohet regjistrimi, pas kontrollit të të dhënave të dhëna , aktivizojmë regjistrimin brënda 24 orëve.

Në faqen e trainimit mund të gjenden lajmet e ditës dhe leksione të tilla që të ndihmojnë në ndërtimin e rrjeteve. Por mund të gjenden edhe informacione të tilla që kanë të bëjnë me orarin e e qënies hapur të magazinave tona.

Mund të vendosni edhe ndjekjen e objektivave tuaja, që të tërheq vëmendjen për arritjen e një niveli apo të programi stimulues, qoftë edhe me kohën e nevojshme për ta arritur atë, duke e shoqëruar me vëmendje në vëndin tënd, madje përmban edhe udhëzuesin e nevojshëm për arritjen e këtyre objektivave.

Lidhur me regjistrimin apo përdorimin e faqes mund të kërkoni ndihmë në Facebook-un zyrtar të Forever Living Products (Hungary) Ltd. ose në qoftë se do me zë live na thirr ne pa hezitim në 06-1-269-5370/ ext.130!

Faqja e Trainimit Forever Business School është falas për të gjithë distributorët që disponojnë numerin kodik të regjistrimit. Leksionet e paraqitura në këtë faqe interneti nuk pasqyrojnë opinionin e FLP, por pikpamjet e pavarura të lektorit. Lektorët nuk garantojnë, që mësimet e dhëna prej tyre do të sigurojnë patjetër sukses , megjithatë që këto leksione do të kontribuojnë për arritjen e suksesit.

Rekomandimi produkteve si profesionist

profin

PRODUKTET E FOREVERIT JANË TË SHKËLQYERA, POR NUK MUND TË SHESIN VETVETEN. QË TË NJOHURIT E TU TË SIGUROJNË NJOHURITË PËR TO, KËRKOHEM NDËRMJETËSIMIYT. NË QOFTË SE KENI QËNË NË TURBO STARTIN E 5-TË TË PRILLIT, ATËHERE JU KUJTOHET, NË QOFTË SE NUK KENI QËNË, ATËHERE PO JU NJOHIM PARAPRAKISHT, DHE PASTAJ MUND TË DËGJONI MATERIALIN E PLOTË NË CD!

Nga media çdo ditë na jepet mesazhi i „krizës”, dhe në përgjithësi mendojmë „njerzit nuk kanë para”. Kundërthënie e kësaj është fakti, që depozitat bankare gjatë krizës janë rritur shumë, që tregon se njerzit janë dhënë pas kursimit. Atëhere çdo të thotë kjo? Atëhere ka apo nuk ka para? Në përgjithësi para ka, vetëm se njerzit tani shikojnë më mirë përse ti prishin, sepse mesazhi i krizës është: mba rezerva! Plus kësaj tregu i plotësuesve dietikë është shpërndarë gjithandej, mund të blihen edhe në dyqane apo nëpërmjet rrjeteve të shitjes. Prandaj ka shumë rëndësi që shërbimi yt të jetë shumë profesionist. Ne kot mund të themi që produktet tona janë të cilësisë më të lartë, gjithkush këtë thotë për produktet e veta, pra blerësi thjesht nga kjo nuk mund të vendosë. Po në çfarë ti je më i mirë? „Dije përse ka nevojë blerësi dhe atë jepi atij!” Mos vendos ti se çfarë i duhet atij, por mëso, çfarë do ai që të ndryshojë. Për këtë duhet që të jesh sinqerisht i interesuar, ti bësh shumë pyetje dhe të dëgjosh me vëmendje çfarë dhe si përgjigjet. Ai ta thotë çfarë kërkon të ndryshojë, sepse për atë vetëm ajo është e vërtetë që ai koncepton. Plus kësaj në qoftë se bën shumë pyetje (nga ato që nuk mund tu përgjigjet me po apo jo, por që duhet zbrëthyer si për shembull: çfarë, pse, qysh...), atëhere ai mund të flas më shumë për vetveten, dhe kjo i krijon një ndjenjë të mirë, se është dikush që e dëgjon, që kujdeset dhe e gjithë kjo i rrit besimin. Në qoftë se ai ka besim tek ti dhe të dëgjon më shumë, kjo do të thotë ekziston mundësia që ai të dëgjojë këshillat e tua. Pyetjet dhe dëgjimi me vëmendje janë mjeti më i mirë i ndërtimit të biznesit. Kur ke mbërritur këtu atëhere mund të japësh ofertën. Edhe për këtë kam disa këshilla, që për hir të mbajtjes shënim më lehtë i kam mbledhur sipas një rendi alfabetik.

Jepi sqarime korekte!

Organizmit tonë, me plotësuesit dietikë, vitaminat e domosdoshme dhe lëndët minerale, i japim ato gjëra që nuk mund ti sigurojë me ushqimet që hamë. Çdo organizëm është mirënjohës për „karburantin” e mirë: përmirësohet gjendja shpirtërore, rritet vitaliteti, dhe përballohet më mirë ngarkesa e punës. Informoje në mënyrë korekte çdo konsumator për mënyrën e sigurimit të këtyre produkteve (për çmimin NDP, çmimin me shumicë...).

Nxit dhe inkurajo!

Tashmë kandidati yt i mundshëm bombardohet me shumë informacion – reklama, oferta nga mjedisi..., të cilat më shumë e turlosin dhe i shtojnë pasigurinë. Tregoji se edhe ti mund të kesh dyshuar në fillim, foli për garancinë e produkteve dhe prit me durim – për efektin duhet kohë!

Mos premo çudira!

Megjithatë dihet që aloe është një bimë çudibërëse dhe këtë tashmë mund



Dr. Samu Terézia:
TERMÉKAJÁNLÁS
profin

ta kesh provuar edhe vetë, që ti ka tejkaluar parashikimet, por ti nuk e di se si do të reagojë ai. Ajo që mund të premtosh me siguri është: përmirësimi i cilësisë të jetës, vitaliteti saj.

Mos u hiq doktor!

Në qoftë se të përmend probleme të vjetra që as vet nuk i di, dërgoje tek doktori! Mos kërko tia zgjidhësh ti problemin, me të mund të dëmtosh veten! Në qoftë se ka një problem të njohur shëndetsor serioz, atëhere drejtohuni së bashku tek mjeku specialist i FLP.

Interesoju për zakonet e konsumatorit tënd!

Për ty janë të rëndësishme për shembull sa kafe apo cigare pi, apo sa gjumë bën. Njerzit nuk i vënë re përmirësimet e vogla dhe ndonjëherë thonë: „nuk më bëri asgjë”. Por në qoftë se ti ia njeh këto zakone dhe e pyet për to, atëhere mund tia konstatosh ndryshimet.

Pranoji në mënyrë aktive këshillat e sponsorit tënd!

Ai është i interesuar për sukseset e tua dhe ka një përvojë të tillë, që në qoftë se ia dëgjon dhe ia pranon, mund ta arrish më shpejt objektivin tënd.

Kujdesu për konsumatorin!

Puna jonë atëhere fillon vertet kur produkti mbërrin tek konsumatori. Nëpërmjet kujdesit tënd do të shtohen blerësit e tjerë, por për këtë temë do tju flasë dhe shkruaj Dr Ilona Juronics

Në qoftë se i respekton këto këshilla....

... dhe i vë ato në jetë, atëhere shpërblimi yt do të jetë suksesi.

Ju uroj shumë suksese!

Dr. Terézia Samu
soaring menaxhere,
mjeke specialiste e FLP



ÇANTA E TESTEVE

KI325 DHE KI326

Në leksionin e tetorit 2013 të mbajtur nga Dietmar Reichle në Trainimin e Diamantëve u njohëm me përdorimin praktik të Test Touch, çantën e testeve me dy lloj përmasash. Urojmë që të jeni një distributor i sukseshëm me sa më shumë konsumatorë potencialë!



PRODUKTET PA PIKË

ÇANTA E VOGËL DHE E MADHE E PSONISJES

KI311 DHE KI312

Vazhdimisht kemi synuar që të jemi miq të ruajtjes të mjedisit të natyrës, për këtë ju prezantojmë me krenari çantën e psonisjes me shumë përdorime Forever Living. Sigurojeni edhe ju këtë çantë për të prezantuar me të produktet tuaja të preferuara! Çanta e madhe nxen 3 Aloe Vera Gel, 1 Pomesteen dhe një shushë ujë Sirona. Është një dhuratë e shkëlqyer edhe për familjen, miqtë apo bashkpunëtorët tuaj më të mirë. Bëhu edhe ti anëtar i Forever Living pjestar i synimeve të ruajtjes të mjedisit!

KOMPLETI FURCAVE PROFESIONALE

KI316

Tregoji aftësitë e tua artistike me kompletin e dhjetë furcave, me ndihmën e të cilave mund të realizosh një pamje të përsosur! Çanta elegante në të cilën vendosen këto furca mund të përdoret kurdo shumë lehtë.



KËMISHA VITAL⁵

KI327 dhe KI328

E disponojmë me ngjyrë të zezë. A i përdorni çdo ditë produktet që ndodhen në kutinë Vital⁵? Me këtë këmishë ju ndihmojmë ti gjeni më lehtë konsumatorët e rinj të Vital⁵.

BLUZA DIAMANT

KI321-324

Shkëlqë si Diamant edhe në Trainimin Diamant të Miklós Berkics





NIVELIN E MENAXHERIT E ARRITËN



Erszébet Bárkányi

(sponsor: Chilla Körmendi dhe Attila Körmendi)

„Kërko shkaqet dhe jo justifikimet!”



Gáborné Bartakovics

dhe **Gábor Bartakovics**
(sponsor: Eszter Tókané Oreovecz dhe Géza Tóka)

„E ardhmja varet gjithmonë nga ajo çka bëjmë sot.”



Andor Balogh

dhe **Andorné Balogh**
(sponsor: Andrea Nagy)

„Atë që mund ta bësh sot, mos e ler për nesër!”



Eszter Tókané Oreovecz

dhe **Géza Tóka**
(sponsor: Lászlóné Pintér dhe László Pintér)

„Jetoje jetën tënde, mos kërko barrë të lehtë, por shpinë të fortë!”



NIVELIN E SUPERVISOR-I E ARRITËN

Ádám Edit & Farkas István
Aleksic Nebojsa & Aleksic Slobodanka
Beczó Ágnes
Csampar János
Dávidné Tóth Mária
Deákné Kormos Erszébet & Deák István
Dr. Fazekas Ferenc & Mészáros Károlyné
Dr. Pető Andrea
Grüner Zoltán & Formanek Eszter Olimpia
Hajdu Péter
Hegyesi István
Homor József
Jovanov Sana & Jovanov Zoran
Keszeg Crinela Elena
Kovács Béla & Kovács Béláné
Kovács Gyöngyi
Kovač Jasna & Kovač Božidar
Lazarević Jelena
Miszori Veronika
Németh Imre
& Németh Imréné
Petróczi Györgyné
Pintér Patrik
Pressel Stéfán
& Pressel Andrea
Pólyik Enikő
Radojević Milica
& Radojević Zlatan
Rapliné Varga Edit
& Rapli Róbert
Sándor Péter László
Simon Ildikó
Stier Gebura Lilla
Stojiljković Marina
& Stojiljković Aleksandar
Svec Norbert & Fedorova Iveta
Váradiné Hauzer Dóra
Vizi Ferenc & Viziné Búzási Krisztina



NIVELIN E ASSISTANT MANAGER-IT E ARRITËN

Bartakovics Gábor
Cirkó József György

60 CC+

02. 2014. TË KUALIFIKUARIT

Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
Pintér Lászlóné & Pintér László
Zachár-Szúcs Izabella & Zachár Zsolt
Rajnai Éva & Grausz András
Szolnoki Mónika
Tókané Oreovecz Eszter & Tóka Géza
Nagy Andrea
Bárkányi Erszébet
Lomjanski Stevan & Lomjanski Veronika

Balogh Andor & Balogh Andorné
Marić Dragana
Iskra Rinalda & Iskra Lučano
Lipovac Alen & Lipovac Dolores
Éliás Tibor
Dr. Kolonics Judit
Bartakovics Gáborné & Bartakovics Gábor
Klaj Ágnes & Rostás László
Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya

Dr. Seresné Dr. Pirkhoffer Katalin
& Dr. Seres Endre
Dr. Fábíán Mária
Tóth János
Tanács Ferenc & Tanács Ferencné
Mogyorósi Péter
Varga Róbert & Varga-Hortobágyi Tímea
Dr. Rokonay Adrienne & Dr. Bánhegyi Péter
Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág

CONQUISTADOR CLUB

02. 2014. DHJETË DISTRIBUTORËT MË TË SUKSESSHËM NË BAZË TË PIKËVE PERSONALE DHE TË NON-MENAXHERIT



HUNGARIA

1. Varga Géza & Vargáné Dr. Juronics Ilona
2. Pintér Lászlóné & Pintér László
3. Zachár-Szücs Izabella & Zachár Zsolt
4. Rajnai Éva & Grausz András
5. Szolnoki Mónika
6. Tókané Oravecz Eszter & Tóka Géza
7. Nagy Andrea
8. Bárkányi Erzsébet
9. Balogh Andor & Balogh Andorné
10. Dr. Kolonics Judit



SERBIA

Dragana Marić



KROACI

Alen Lipovac & Dolores Lipovac



SLLOVENIA

Rinalda Iskra & Lučano Iskra



FITUESIT E PROGRAMIT MOTIVUES TË BLERJES SË MAKINËS

NIVELI 1-RË

Jožica Arbeiter & Dr. Miran Arbeiter
 Becz Zoltán & Kenesei Zsuzsanna Viktória
 Bruckner András & Dr. Samu Terézia
 Marija Buruš & Boško Buruš
 Csuka György & Dr. Bagoly Ibolya
 Davis Erika & Davis Henry
 Dobai Lászlóné & Dobai László
 Dr. Dósa Nikolett
 Éliás Tibor
 Fekete Zsolt & Ruskó Noémi
 Ferencz László & Dr. Kézsmárki Virág
 Olivia Gajdo
 Gecse Andrea
 Gombás Csilla Anita & Gombás Attila
 Gyurik Erzsébet & Sándor József
 Hajcsik Tünde & Láng András
 Heinbach József & Dr. Nika Erzsébet
 Rinalda Iskra & Lučano Iskra
 Vladimir Jakupak & Nevenka Jakupak
 Dragana Janović & Miloš Janović
 Juhász Csaba & Bezzeg Enikő
 Dr. Keresztényi Albert
 Kis-Jakab Árpád & Kis-Jakabné Tóth Ibolya
 Dr. Kiss Ferenc & Dr. Nagy Ida

Klaj Ágnes & Rostás László
 Manda Korenić & Ecio Korenić
 Jadranka Kraljić-Pavletić & Nenad Pavletić
 Kúthi Szilárd
 Lopiczné Lenkó Orsolya & Lopicz Tibor
 Mázás József
